

(Lajme per Shqiperine)

Spanja vendosi marredhenie diplomatike me  
Shqiperine

MADRID, 12 shtator /TANJUG/.- Spanja vendosi zyrtarisht sot marredhenie diplomatike me Shqiperine. Ambasadori spanjoll ne Beograd, Luis Kuervo, do te perfaqesoje vendin e tij edhe ne Tirane.

Sipas komunikates zyrtare, vendosja e marredhenieve diplomatike me Tiranen eshte ne perputhje me parimin e marredhenieve universale, qe respektohet nga qeveria spanjolle. Mbi bazen e ketij parimi, qeveria e kryeministrit Felipe Gonzales vendosi kohet e fundit marredhenie diplomatike me Izraelin.

Spanja ende nuk ka marredhenie me Republiken Popullore Demokratike te Korese dhe me nje numer shtetesh me te vogla.

Sikurse njoftohet, vendosja e marredhenieve midis Madridit dhe Tiranes eshte bere nepermjet ambasadave ne vendet e treta, sidomos Francës, dhe nepermjet kontakteve në organe te ndryshme nderkombetare. -Joçi.M.Tu./ATSH/